

Rezolutë e Konferencës së vitit 2013 për Marrëdhëniet ndërmjet Institucioneve të Larta të Auditimit dhe Parlamenteve, Budva, Mali i Zi

Ne, Kryetarët e Institucioneve të Larta të Auditimit të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale për BE, me mbështetjen e Gjykatës Europiane të Audituesve, u takuam në Budva në 19 nëntor 2013,

Duke kujtuar Marrëveshjen e Stambollit, në veçanti:

- angazhimin për të vazhduar të luajmë rolin tonë në zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve pozitive ndërmjet ILA-ve dhe parlamenteve kombëtare, mbi bazën e respektit reciprok për rolin dhe pavarësinë e të dyja palëve;
- vendimin për të organizuar një konferencë mbi rëndësinë e rritjes së marrëdhënieve konstruktive ndërmjet ILA-ve dhe parlamenteve, si edhe organeve të tjera të administratës publike;

Duke pranuar parimet tashmë të parashikuara në Dokumentin nr. 33 të SIGMA-s mbi Marrëdhëniet ndërmjet Institucioneve të Larta të Auditimit dhe Komisioneve Parlamentare (Sigma, Paris, 2002), kryesisht që:

- llogaridhënia, transparenca dhe vlera e parasë në përdorimin e fondeve publike janë elemente themelore të qeverisë demokratike;
- qeveria pritet të japë llogari për administrimin e parave të taksapaguesve tek përfaqësuesit e zgjedhur në parlament dhe tek publiku në përgjithësi;
- ILA-të mund të japin një kontribut shumë të rëndësishëm në këtë proces administrimi duke ofruar një vlerësim të pavarur, informacion, garanci dhe këshilla për llogaritë e paraqitura nga qeveria, si edhe për realizimin e programeve, projekteve, iniciativave dhe aktiviteteve të tjera të filluara nga qeveria;

Duke mirëpritur Rezolutën A/66/209 të OKB-së 22 dhjetor 2011 në të cilën Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara inkurajon të gjitha shtetet anëtare të OKB-së të zbatojnë parimet e përcaktuara në deklaratat e Limës dhe Meksikës, duke treguar kështu mbështetjen e gjerë për zbatimin e këtyre parimeve themelore;

Duke vënë në dukje se në këtë rezolutë të OKB-së pavarësia e veprimtarisë së ILA-ve theksohet si element themelor për funksionimin e mirë të ILA-ve dhe që thirrja që bën rezoluta e OKB-së për ILA të forta nënkupton që vihen në dispozicion burime të mjaftueshme financiare;

Duke marrë në konsideratë konkluzionet e Konferencës së Budvës mbi Marrëdhëniet ndërmjet Institucioneve të Larta të Auditimit dhe parlamenteve të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale për BE:

- *efektiviteti i ILA-ve si auditues publikë dhe nxitës të transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë lidhet drejtpërdrejtë me aftësinë e tyre për të angazhuar dhe bashkëpunuar me aktorët e tyre, veçanërisht me parlamentet në rolin e tyre të mbikëqyrës;*
- *kjo duhet të bazohet tek respekti i ndërsjellë për pavarësinë, rolin dhe përgjegjësinë e ILA-ve dhe parlamenteve në të gjithë sistemin e llogaridhënies demokratike;*

- një mbështetje dhe bashkëpunim i tillë duhet të kuptohet në situatën kur ILA-të dhe parlamentet kanë të njëjtin qëllim të garantimit të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe llogaridhënies në të mirë të qytetarëve, përfshirë kontributin në luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit;
- mënyra më e mirë për të arritur këtë qëllim të përbashkët nënkupton vlerësimin e praktikave aktuale, identifikimin e praktikave të mira dhe maksimizimi i përpjekjeve të përbashkëta të ILA-ve dhe parlamenteve; dhe,
- duke vepruar kështu, kontribuojnë për forcimin e zinxhirit të llogaridhënies dhe shtrimin e rrugës për anëtarësim në BE.

Duke vënë në dukje veçanërisht propozimin për hartimin e udhëzuesit të përshtatshëm që do të përdorej nga ILA-të dhe parlamentet individuale për të forcuar bashkëpunimin e tyre të dobishëm reciprok;

Vendosëm:

- të monitorojmë rregullisht në secilin vend progresin e zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet ILA-ve dhe parlamenteve;
- që për këtë qëllim, duhet të krijohet një udhëzues i përshtatshëm nga një grup pune i përbërë nga pikat e kontakti dhe/ose ekspertët përkatës.

Miraturar në Budva, Mali i Zi, 19 nëntor 2013